



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1386 Prot.

Tiranë, më datë 08.11.2023

VENDIM
Nr. 544, datë 08.11.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, Vendimit Nr. 220, datë 07.04.2021 “Për përcaktimin e procedurave për hulumtimet arkeologjike, të kushteve të posaçme të lëshimit të lejes, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin ose anulimin e lejes për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike” dhe “Regullorja e arkeologut”, Vendimit Nr. 2, datë 30.01.2009, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.11.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e Konceptit të gërmimit arkeologjik “Për gjetjet arkeologjike në shkollën Gjergj Kastrioti”, Brenda Zonës Arkeologjike “B” Durrës, realizuar nga subjekt i licencuar z Luan Përzhitia, me zhvillues **Bashkia Durrës**.
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të realizoj gërmimin arkeologjik sipas konceptit të hartuar në kuadër të projektit “Gjetjet arkeologjike në shkollën Gjergj Kastrioti”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
3. Gjatë realizimit të gërmimit arkeologjik, subjekti i licensuar në arkeologji dhe investitori duhet të marin masa për konservimin paraprak të gjurmëve të mozaikut;
4. Raporti i rezultateve të gërmimit arkeologjik, së bashku me propozimet mbi gjetjet arkeologjike, të cilat do të zbulohen, të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM-së;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

